



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 108 DATË 18.12.2024 “ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2025 DHE PBA 2025-2027 ”, i ndryshuar,
(shtesë e buxhetit 2025 me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e detyrimeve dhe detajimi i saj)

Këshilli Bashkiak Berat, sot në datën ____/____/2025, pasi u njoh me materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Berat “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027 ”, i ndryshuar, (shtesë e buxhetit 2025 me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e detyrimeve dhe detajimi i saj)”, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 40, pika 1, neni 41, pika 2”b”, neni 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”i ndryshuar, Aktit Normativ Nr. 11 datë 19.12.2025 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar , me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”, i ndryshuar, bëhet shtesë si më poshtë:

- a- Shtesë e të ardhurës nga Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme shuma 29,264,858 lekë
- b- Shtesë në shpenzime shuma 29,264,858 lekë e detajuar si më poshtë :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				29,264,858
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			17,366,172
2102001	01	AA102	V111AAG	602	Shpenzime per Vendime Gjyqesore	17,366,172
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			11,760,686

6

2102001	01	AC102	P912AAR	231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" dhe parkim nëntokësor	11,760,686
		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			138,000
2102001	01	AF102	V823AAC	602	Blerje materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres	138,000
					Total	29,264,858

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____/_____/2025

MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT " MBROJTJA NGA GËRRYERJA E LUMIT OSUM , RRUGA BYPASS , PRANË URËS SË BILCËS" DHE MIRATIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT PREJ 44,977,207.04 LEKË, TË KËRKUAR PËR FONDET E EMERGJENCAVE CIVILE PRANË AGJENSISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____/_____/2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr 45/2019 " Për mbrojtjen civile", VKM nr 414 datë 08.07.2021" Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", VKM nr. 53, datë 01.02.2023 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile" pika 7, germa a dhe b,

VENDOSI :

1.MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTIT " MBROJTJA NGA GËRRYERJA E LUMIT OSUM , RRUGA BYPASS , PRANË URËS SË BILCËS" DHE MIRATIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT PREJ 44,977,207.04 LEKË, TË KËRKUAR PËR FONDET E EMERGJENCAVE CIVILE PRANË AGJENSISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Emergjencave Civile,Transportit dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave,

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR

I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa Çela